



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:134127

Datë: 02.05.2024

Numri i dokumentit: 05645248

C.nr. 1282/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Dora Bajrami në çështjen juridike kontestimore të paditësit K.K. nga fshati Komuna e Suharekës, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.Q. avokat në Prizren, kundër të paditurve Sh.Q. dhe A. Q. që të dy nga fshati Komuna e Prizrenit, të cilët me autorizim i përfaqëson A.H. avokat në Prizren, me objekt kontesti pasurim i pabazë, jashtë seance më datë 02.05.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. NDËRPRITET PROCEDURA në këtë çështje juridike të paditësit K.K. nga fshati Komuna e Suharekës, kundër të paditurve Sh.Q. dhe A.Q. që të dy nga fshati Lubizhdë Komuna e Prizrenit, në çështjen juridike pasurim i pabazë, për shkak të zgjidhjes së çështjes paraprake.
- II. Paditësi udhëzohet se mund ta kërkon vazhdimin e procedurës kontestimore pas plotësimit të kushteve ligjore sipas nenit 280 të LPK-së.

A r s y e t i m

Paditësi K.K. nga fshati Komuna e Suharekës, përmes të autorizuarit të tij av. M.Q. ka ushtruar padi me datë: 25.06.2021 kundër të paditurve Sh.Q. dhe A.Q. që të dy nga fshati Komuna e Prizrenit, për shkak të pasurimit të pabazë.

Më datë 26.04.2024, gjykata ka mbajtur seancën përgatitore, me ç' rast i autorizuari i paditësit av.M.Q. i ka propozuar gjykatës që konform nenit 278 të LPK-së të ndërpritet procedura kontestimore pasi që paditësi ka paraqitur kallëzim penal për veprën penale të mashtrimit kundër të paditurve, ndërsa Prokuroria Themelore në Prizren në lidhje me këtë rast ka nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve dhe ka ngritur aktakuzë e cila pranë kësaj gjykate mban numrin P.nr. 467/202 dhe numër të smil 2021:190992. Andaj nisur nga këto rrethana ka theksuar se është në interes të paditësit që kjo çështje kontestimore të ndërpritet deri në përfundimin e çështjes penale.

I autorizuari i të paditurve Av. A.H. nuk e ka kundërshtuar propozimin e të autorizuarit të paditësit për ndërprerjen e procedurës kontestimore.

Nisur nga një gjendje e tillë, kjo gjykatë ka verifikuar nëse ndaj palëve të njëjta është duke u zhvilluar një procedurë penale dhe ka gjetur se në mes të njëjtave palë ndërgjyqëse në Departamentin e Përgjithshëm –Penal, pranë kësaj gjykate është e regjistruar lënda me numrin, P.nr.467/2022 dhe mban statusin e lëndës aktive.

Pas vlerësimit të kësaj situatë gjykata arrin në përfundimin se janë plotësuar kushte ligjore që të bëhet ndërprerja e procedurës në këtë kontest në kuptim të dispozitës së nenit 278 par. 2 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se *“Gjykata mund ta caktojë ndërprerjen e gjykimit në qoftë se vendimi mbi kërkesëpadinë varet nga fakti nëse është kryer delikti ekonomik apo vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, kush është kryerësi dhe nëse ai është i përgjegjshëm, e sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose eksperti ka dhënë deklaratë të rreme, apo se dokumenti i përdorur si mjet provues është i rremë”*.

Gjykata vendosi si në pikën II të këtij aktvendimi konform nenit 280 par.3 të LPK-së përmes së cilit është përcaktuar se: *“Po që se gjykata e ka ndërprerë gjykimin nga shkaqet e përmendura në nenin 278 paragrafi 1 pika a) dhe paragrafi 2 të këtij ligji, gjykimi do të vazhdojë pasi të përfundojë procedura në formë të prerë tek gjykata apo organi tjetër kompetent, apo kur gjykata e çështjes konstaton se nuk ekzistojnë më arsyet për të pritur përfundimin e saj”*.

Andaj duke marrë parasysh të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, e konform nenit 142, 278 par.2 dhe nenit 387 pika e) të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së).

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1282/2021 dt.02.05.2024

G j y q t a r j a

Diora Bajrami

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, drejtuar Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj gjykate.